

VENDIM
Nr. 444, datë 22.7.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH
TË MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT TË *BYPASS*-EVE TË RRUGËS SË FIERIT DHE TË VLORËS,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 8/2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të *bypass*-eve të rrugës së Fierit dhe të Vlorës, ratifikuar me ligjin nr. 8/2012, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**BANKA EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Faks: (355) (4) 2228 494

26 prill 2021

I nderuar zotëri,

Lënda: Projekti i *bypass*-eve të rrugës së Fierit dhe të Vlorës – Operacioni nr. 42319

1. Lutemi t’i referoheni Marrëveshjes së Huas të datës 24 nëntor 2011 (“Marrëveshja e Huas”) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”).

2. Shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas kanë të njëjtat kuptime si këtu.

3. Në zbatim të seksionit 2.02(f) të Marrëveshjes së Huas, Data e Fundit e Vlefshmërisë për kredinë është 31 janari 2021.

4. Ne e pranojmë marrjen e letrës së Huamarrësit të datës 12 prill 2021, në të cilën Huamarrësi ka kërkuar nga Banka që të shtyjë datën e fundit të vlefshmërisë të kredisë në 30 qershor 2022.

Në përputhje me seksionin 3.01(a) të Termave Standarde dhe Kushteve të datës 1 tetor 2007, Banka shtyu datën e fundit të vlefshmërisë të kredisë deri më 30 qershor 2022.

5. Kjo letër nuk ndikon apo ndryshon në asnjë mënyrë detyrimet e ripagimit të Huamarrësit sipas seksionit 2.02(e)(1) të Marrëveshjes së Huas ose ndryshon ndonjë detyrim tjetër të Huamarrësit, sipas Marrëveshjes së Huas

6. Përmbajtja e kësaj letre nuk do të dëmtojë asnjë të drejtë, fuqi ose korrigjim të Bankës, në lidhje me ndonjë kusht tjetër të Marrëveshjes së Huas dhe as nuk interpretohet si heqje dore ose një pranim i saj.

I juaji sinqerisht,

Nënshkrimi

Azmat Khurshid

Drejtor i Asociuar

Departamenti i Administrimit të Operacioneve

One Exchange Square, London EC2A 2JN, United Kingdom
Telefon: +44 20 7338 6000 email: OAD@EBRD.COM www.ebrd.com